

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-100/2014

Prishtinë,
10 dhjetor 2014

Në çështjen juridike të:

S. Zh.
Prishtinë

Pala Ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Willem Brouwr, Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00167) të datës 21 gusht 2013, pas seancës së mbajtur më 10 dhjetor 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e S. Zh.kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 të datës 21 gusht 2013.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 i datës 21 gusht 2013 për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA00167.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 1 gusht 2006, ka pranuar më 2 gusht 2006, Pala ankuese ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkonte ri-posedim të ngastrave nr. 4397/1 dhe 4398, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinës (tani e tutje: prona e kërkuar). Në kërkesën e tij ai thekson se babai i tij, F. Zh. (tani e tutje: babai i Paraqitësit të kërkesës), që kishte vdekur më 1 qershor 2004, është bartësi i së drejtës pronësore. Ai gjithashtu kërkon zhbërjen e shpronësimit të pronës së kërkuar.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij, Paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar dokumentet vijuese:
 - Kontratën e Blerjes OV.br.794/64, të vërtetuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 21 prill 1964, të lidhur në mes babait të Paraqitësit të kërkesës dhe J. S. J. lidhur me pronën e kërkuar, atëherë të njohura si ngastrat me numrat 934 dhe 935;
 - Kërkesën e babait të Paraqitësit të kërkesës drejtuar Komunës së Prishtinës më 10 nëntor 1998, ku kërkon ndryshim të Vendimit nr. 07-464-65/77, me të cilin Komuna e Prishtinës ka shpronësuar pronën e kërkuar më 7 tetor 1977 (p. 012/63);
 - Deklaratën e Paraqitësit të kërkesës të datës 16 mars 2009. Paraqitësi i kërkesës sqaron në këtë deklaratë ndryshimin e bërë brenda Zyrës Kadastrale të Prishtinës lidhur me ngastrat me numrat 934 dhe 935 në numra të ri.
 - Deklaratën e Komunës së Prishtinës lidhur me historikun e ngastrave kadastrale nr. 934 dhe 935 të datës 14 qershor 2010. Ky dokument sqaron se në vitin 1960 ngastrat kadastrale nr. 934 dhe nr. 935 janë ndryshuar në ngastrat nr. 4397 dhe 4398.
3. AKP ka bërë notifikimin e kërkesës.
4. Asnjë palë tjetër nuk i është bashkangjitur procedurës para KKPK-së.
5. AKP ka shtuar në lëndë, sipas detyrës zyrtare, tri Fleta Poseduese:
 - Fletën Poseduese nr. 4137, të lëshuar më 20 gusht 2008 nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Prishtinës; në këtë Fletë Poseduese shkruan se ngastrat ne numrat 4397/1 dhe 4398/1 në Zonën Kadastrale të Prishtinës janë të regjistruara si pronë publike/shtetërore (Pasuri Shoq.-Shfryt-Kuvendi Komunal).
 - Fletën Poseduese nr. 8317, të lëshuar me të njëjtën datë dhe nga i njëjti institucion. Në këtë Fletë Poseduese shkruan se ngastra nr. 4398/3 në Zonën Kadastrale të Prishtinës është e evidentuar në emër të Palës ankuese.
 - Fletën Poseduese nr. 8400, të lëshuar në të njëjtën datë dhe nga i njëjti institucion. Në këtë Fletë Poseduese shkruan se ngastra nr. 4398/3 në Zonën Kadastrale të Prishtinës është e evidentuar në emër të U.A. (O) dhe U. O. (A).
6. Në vendimin e kundërshtuar të datës 21 gusht 2013 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) ka hedhur poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit. Në arsyetimin e vendimit të vet, KKPK thekson se sipas provave të dorëzuara në favor të kërkesës,

Paraqitësi i kërkesës nuk e ka provuar se kërkesa e tij përfshinë rrethana që drejtpërdrejtë ndërlidhen apo që rezultojnë nga konflikti i viteve 1998/99.

7. Vendimi i është dorëzuar Palës ankuese më 24 shkurt 2014.
8. Më 5 mars 2014 është pranuar nga AKP, më 10 mars 2014 Pala ankuese ka paraqitur ankesë në Kolegjin e AKP-së të Gjykatës Supreme.

Pretendimet e Palës ankuese

9. Pala ankuese pretendon se babai i tij është pronari i ligjshëm i pronës së kërkuar. Ai deklaron se prona e kërkuar ishte shpronësuar nga Komuna e Prishtinës në vitin 1977 dhe se ky shpronësim nuk mund të qëndroj. Pala ankuese shton se ai nuk kishte marrë asnjë kompensim dhe nuk kishte procedurë gjyqësore para se të merrej prona e kërkuar. Pala ankuese gjithashtu thekson se nga momenti i shpronësimit (në vitin 1977), familja e tij nuk ka qenë në posedim të pronës së kërkuar.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria

10. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit 30 ditore siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale (tani e tutje: Ligji nr. 03/L-079).

Meritat

11. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079 – për aq sa vlen për këtë rast – KKPK ka kompetencë që të zgjidh kërkesat (pronësore) që kanë të bëjnë me konfliktin që përfshijnë rrethanat që drejtpërdrejtë ndërlidhen apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.
12. Në rastin aktual nuk kontestohet se pjesa më e madhe e pronës së kërkuar ishte shpronësuar nga babai i Palës ankuese në vitin 1977. Pala ankuese nuk ka përmendur rrethana të tjera relevante që e ndërlidhin kërkesën e tij për zhbërje të shpronësimit, të kuptuar si kërkesë për humbje të pronësisë ose ndryshe përcaktim të pronësisë mbi pronën e kërkuar, me konfliktin e armatosur. Prandaj, kërkesa nuk është e ndërlidhur me konfliktin e armatosur të periudhës 27 shkurt 1998 - 20 qershor 1999, siç parashihet me nenin 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079. Gjykata Supreme konstaton se KKPK me të drejtë ka hedhur poshtë kërkesën si kërkesë që bie jashtë juridiksionit të vet.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it